

VENDIM
Nr. 749, datë 19.12.2018

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS
SHTETËRORE, PËRGJEGJËSE PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE DHE
LIDHJEN E TRAKTATIT TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
BASHKIMIN EVROPIAN**

(ndryshuar me VKM nr. 17, datë 11.1.2024)

(përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
2. Struktura e negociatave ka si qëllim arritjen e këtyre objektivave:
 - a) realizimin e procesit të shqyrtimit të përafrimit dhe të vlerësimit të legjislacionit të brendshëm me *acquis* të Bashkimit Evropian (*screening*);
 - b) përcaktimin dhe hartimin e qëndrimeve negociuese të Republikës së Shqipërisë për secilin kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian;
 - c) negocimin dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

II. STRUKTURA E NEGOCIATAVE

- 1.Struktura përgjegjëse për negociatat përbëhet nga:
 - a)Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian;
 - b) Delegacioni Shtetëror;
 - c) grupi negociator;
 - ç) Misioni i Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
 - d) Sekretariati i Integritimit Evropian;
 - dh) grupet ndërinstitucionale të punës;
 - e)Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian.
2. Organizimi, veprimtaria, funksionimi dhe bashkërendimi i punës së strukturave midis njëra-tjetres dhe më gjerë kryhen me akt të veçantë.

III.KOMITETI SHTETËROR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian krijohet si organi më i lartë që siguron mbikëqyrjen e strukturës së negociatave dhe bashkërendimin e qëndrimit negociues për secilin kapitull të *acquis*, përpara miratimit nga Këshilli i Ministrave.
2. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian drejtohet nga Kryeministri dhe në të marrin pjesë:
 - a) Kryetari i Delegacionit Shtetëror;
 - b) *ministër i Shtetit dhe Kryenegociator*;
 - c) ministrat përgjegjës për çështjet e brendshme, të ekonomisë, financës dhe drejtësisë;
 - ç) Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.
3. Në Komitetin Shtetëror për Integrimin Evropian merr pjesë, gjithashtu, ministri që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, si dhe ftohen të marrin pjesë kryetarët e institucioneve të pavarura, sipas tematikës së diskutimit për secilin kapitull të *acquis*.

4. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian mbështetet nga grupi negociator, siç përcaktohet në kreun V, të këtij vendimi. Procedurat dhe organizmi i punës së Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian miratohen me urdhër të Kryeministrit, *me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator*.

5. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian vlerëson dhe bashkërendon qëndrimin negociues për secilin kapitull të *acquis*, të paraqitur nga *ministri i Shtetit dhe Kryenegociator*, sipas përcaktimit në pikën 5, të kreut V, të këtij vendimi, me opinionin e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian.

6. Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian orienton ministrin që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore për kapitullin përkatës të *acquis* dhe *ministër i Shtetit dhe Kryenegociator* për propozimin për qëndrimin negociues që do t'i paraqitet për miratim Këshillit të Ministrave.

7. *Këshilli i Ministrave miraton qëndrimin negociues për secilin grup-kapitull të acquis-it, me bashkëpropozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator dhe të ministrave që mbulojnë fushën e përgjegjësisë shtetërore për kriteret dhe kapitujt e acquis-it, sipas parashikimeve të këtij vendimi.*

IV. DELEGACIONI SHTETËROR

1. Delegacioni Shtetëror është organi përgjegjës për zhvillimin e dialogut politik dhe të negociatave me institucionet e Bashkimit Evropian, përfshirë hapjen dhe mbylljen e negociatave për secilin kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian.

2. Delegacioni shtetëror përbëhet nga:

- a) ministri përgjegjës për punët e jashtme, në funksionin e kryetarit;
- b) *ministër i Shtetit dhe Kryenegociator*, në funksionin e zëvendëskryetarit;
- c) kreu i Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian;
- ç) përfaqësues të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore, në varësi të fushës së përgjegjësisë shtetërore që është objekt diskutimi me institucionet e Bashkimit Evropian.

3. Delegacioni Shtetëror është përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave dhe vepron në përputhje me qëndrimet negociuese të miratuara prej tij, sipas përcaktimit të pikës 6, të kreut III, të këtij vendimi.

4. Delegacioni Shtetëror përfaqëson Republikën e Shqipërisë në Konferencën Ndërqeveritare Shqipëri - Bashkimi Evropian, në kuadër të negociatave të aderimit në Bashkimin Evropian.

5. Në ushtrimin e funksioneve të tij, delegacioni shtetëror mbështetet nga grupi negociator dhe Sekretariati i Integritimit Evropian.

V. GRUPI NEGOCIATOR

1. Grupi negociator krijohet si organi përgjegjës për zhvillimin e procesit teknik të negociatave të aderimit me institucionet e Bashkimit Evropian për çdo kapitull të *acquis* dhe *kriteret e Bashkimit Evropian*.

2. *Grupi negociator përbëhet nga Kryenegociatori dhe jo më pak se 7 (shtatë) anëtarë. Përbërja e grupit negociator dhe rregullat e funksionimit të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator.*

3. Grupi negociator ka përgjegjësitë, si më poshtë vijon:

a) *diskuton, vlerëson dhe i propozon Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian shqyrtimin e projektpropozimeve për qëndrimet negociuese për çdo grup-kapitull të acquis-it, të bashkëpropozuara nga negociatorët përkatës të grup-kapitullit, sipas projektpropozimeve të hartuara nga grupet ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull dhe kriter të acquis-it.*

b) zhvillon procesin e diskutimeve e të negociatave për çdo kapitull të *acquis*, në përputhje me qëndrimet negociuese të miratuara nga Këshilli i Ministrave;

c) monitoron dhe bashkërendon zbatimin e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të dokumenteve strategjike për procesin e Integritimit Evropian;

ç) ndjek zbatimin e kërkesave dhe të udhëzimeve të Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian;

d) raporton në Komitetin Shtetëror për Integrimin Evropian për veprimtaritë në kuadër të

procesit të integritimit në Bashkimin Evropian;

dh) drejton procesin e përditësimit të planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

e) vlerëson dhe finalizon dokumentet dhe raportet e përgatitura në kuadër të takimeve të Komitetit dhe nënkomiteteve të stabilizim-asociimit;

ë) vlerëson ndikimin në financat publike të buxhetit të shtetit të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

f) vlerëson ndikimin e përafrimit të legjislacionit të brendshëm me *acquis*;

g) vlerëson përparësitë e programit të Bashkimit Evropian të Asistencës (IPA), ecurinë e projekteve të financuara nga programet e Asistencës së Bashkimit Evropian apo nga donatorë të tjerë në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

gj) çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me akt të veçantë.

4. *Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator i paraqet për shqyrtim Komisionit për Çështjet Evropiane projektpropozimet e qëndrimit negociues për grup-kapitullin përkatës të acquis-it.*

5. *Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator i paraqet për shqyrtim Komitetit Shtetëror për Integritimin Evropian projektpropozimet e qëndrimit negociues për grup-kapitullin përkatës të acquis-it, sipas parashikimeve të këtij vendimi, si dhe informon për rekomandimet e Komisionit për Çështjet Evropiane për qëndrimin negociues.*

6. Anëtarët e grupit negociator bashkëkryesojnë nënkomitetet e stabilizim-asociimit Shqipëri-BE.

7. Grupi negociator mbështetet në funksionet e tij nga Sekretariati i Integritimit Evropian, siç përcaktohet në kreun VII, të këtij vendimi.

VI. MISIONI I SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Misioni i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian është përgjegjës për:

a) mbështetjen e komunikimit diplomatik dhe teknik me institucionet e Bashkimit Evropian dhe me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian;

b) organizimin e agjendës së takimeve dhe të shkëmbimit të qëndrimeve përkatëse të palëve për çështjet e diskutuara në kuadër të negociatave për çdo kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian.

VII. SEKRETARIATI I INTEGRIMIT EVROPIAN

1. *Sekretariati i Integritimit Evropian (sekretariati) është departamenti përgjegjës për integritimin, në Kryeministri.*

2. Sekretariati është përgjegjës për koordinimin e politikave kombëtare me ato të Bashkimit Evropian dhe ofron asistencë teknike e administrative për Komitetin Shtetëror për Integritimin Evropian, Delegacionin Shtetëror, grupin negociator dhe grupet ndërinstitucionale të punës në përgatitjen e negociatave për secilin kapitull të *acquis*.

3. *Sekretariati i Integritimit Evropian, përveç detyrave funksionale në Kryeministri, ushtron edhe këto funksione:*

a) bashkërendon dhe mbështet aktivitetin e grupeve ndërinstitucionale të punës si në kuadër të detyrimeve të procesit të stabilizim-asociimit, ashtu edhe në kuadër të procesit të negociatave për çdo kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian;

b) bashkërendon dhe mbështet hartimin e raportit analitik përfundimtar të harmonizimit të legjislacionit vendas me *acquis* të Bashkimit Evropian (*screening*) nga secili grup ndërinstitucional pune, siç përcaktohet në kreun VIII, të këtij vendimi;

c) mbledh dhe përpunon projektpropozimet për qëndrimet negociuese për çdo kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian, sipas projektpropozimeve dhe qëndrimeve negociuese të hartuara nga secili grup ndërinstitucional pune, siç përcaktohet në kreun VIII, të këtij vendimi;

ç) koordinon ndërveprimin dhe shkëmbimin e qëndrimeve negociuese e të dokumentacionit përkatës ndërmjet Komitetit Shtetëror për Integritimin Evropian, Delegacionit Shtetëror, grupit negociator dhe ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator me grupet ndërinstitucionale të punës;

d) administron bazën e të dhënave elektronike për monitorimin e procesit të negociatave dhe të detyrimeve që rrjedhin prej tij;

dh) kryen funksione të tjera teknike dhe administrative, që përcaktohen nga kryetari i Delegacionit Shtetëror dhe *ministri i Shtetit dhe Kryenegociator*, në kuadër të procesit të negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

4. Sekretariati i kryen funksionet e tij nën udhëzimet e *ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator*.

5. *Shfuqizuar*.

VIII. GRUPET NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Për secilin kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian krijohet një grup ndërinstitucional pune.

2. Grupet ndërinstitucionale të punës janë përgjegjëse për:

a) analizën e politikave, të legjislacionit, financimit, investimeve, procedurave administrative, ndërveprimit social e të sipërmarrjes private dhe të zbatimit gjyqësor për fushën përkatëse, të mbuluar nga kapitulli përkatës i *acquis*;

b) përgatitjen e vlerësimit analitik të harmonizimit të legjislacionit vendas me *acquis* të Bashkimit Evropian;

c) përgatitjen e propozimeve për qëndrimet negociuese për çdo kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian dhe përcjelljen e tyre te grupi negociator;

ç) përgatitjen e dokumentacionit dhe të raporteve vlerësuese për piketat paraprake (*opening benchmarks*) dhe piketat përfundimtare (*closing benchmarks*) për kapitullin përkatës, duke përfshirë edhe diskutimet apo qëndrimet e dala në negociatat për atë kapitull;

d) analizimin në mënyrë periodike të kapaciteteve administrative dhe rekomandimin për forcimin e tyre, kur është e nevojshme;

dh) përcaktimin, në konsultim me anëtarin e grupit negociator përgjegjës për kapitullin përkatës, të prioritetëve të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe përditësimin periodik të këtij përafrimi;

e) çdo detyrë tjetër, në kuadër të përgatitjes dhe zhvillimit të negociatave të aderimit në Bashkimin Evropian, sipas kërkesës së *ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator*.

3. Përgjegjësitë e ministrive të linjës apo të institucionit të pavarur në secilin grup ndërinstitucional pune dhe struktura e tyre caktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator.

4. Strukturat e integritetit evropian në ministritë, institucionet e pavarura dhe institucionet në varësi të Kryeministrit/ministrave, mbështesin funksionimin e secilit grup ndërinstitucional pune, në cilësinë e sekretariatit teknik të tij, sipas fushës së kompetencës, nëpërmjet koordinimit të strukturave të institucionit ku ato bëjnë pjesë, sa herë i kërkohet nga kryetari i grupit ndërinstitucional të punës përkatës.

5. Grupi ndërinstitucional i punës kryesohet nga një zëvendësministër ose sekretari i përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse, në varësi të fushës së kompetencës dhe lidhjes së saj me kapitullin përkatës të *acquis* të Bashkimit Evropian apo përfaqësuesi i institucionit të pavarur, kur fusha e kompetencës për kapitullin e caktuar të *acquis* i takon një institucioni të pavarur.

6. Kryetari i secilit grup ndërinstitucional të punës administron grupin e punës në përputhje me kërkesat e anëtarit të grupit negociator përgjegjës për negociatat për kapitullin në fjalë. Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës është përgjegjës për veprimtarinë e tij tek anëtari përkatës i grupit negociator përgjegjës për koordinimin e një kapitulli negociues të veçantë.

7. Kryetari dhe anëtarët e secilit prej grupeve ndërinstitucionale të punës emërohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrave apo drejtuesve të institucioneve të pavarura përgjegjëse. Në përbërjen e grupeve ndërinstitucionale të punës, përveç përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse për secilin kapitull, mund të bëjnë pjesë dhe ekspertë, sipas fushës së tyre të kompetencës.

8. Kryetarët e grupeve ndërinstitucionale të punës organizojnë Komitetin Teknik të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës. Rregullat e funksionimit të Komitetit miratohen me urdhër të Kryeministrit.

9. Në funksion të procesit të stabilizim-asociimit, grupet ndërinstitucionale të punës janë përgjegjëse për dorëzimin pranë ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator të kontributit:

- a) në Planin Kombëtar të Integrimit Evropian;
- b) për raportin vjetor të Komisionit Evropian;
- c) për të gjitha raportet periodike në lidhje me procesin e stabilizim-asociimit;
- ç) për 7 nënkomitetet e stabilizim-asociimit;
- d) për takimin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit;
- dh) për takimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit.

IX. PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Informimi, konsultimi, komunikimi dhe përfshirja e shoqërisë civile, grupeve të interesit, sindikatave, botës akademike dhe organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian si dhe në procesin e stabilizim-asociimit realizohen nëpërmjet Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian.

2. Pjesëmarrja e shoqërisë civile, grupeve të interesit, biznesit, sindikatave, botës akademike dhe organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian për monitorimin e politikave publike gjatë procesit të negocimit nëpërmjet Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, si dhe dhënia e ekspertizës në fusha të ndryshme të *acquis* të Bashkimit Evropian është e hapur për to, sipas fushës përkatëse të kompetencës.

3. Format e pjesëmarrjes, funksionimi dhe struktura institucionale e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian miratohen me urdhër të Kryeministrit.

X. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Çdo efekt financiar, që mund të lindë nga zbatimi i këtij vendimi, përballohet nga buxheti vjetor, i miratuar për ministritë dhe institucionet zbatuese.

2. Ngarkohen ministritë, institucionet e pavarura dhe institucionet në varësi të Kryeministrit/ministrave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi